



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
KESHILLI

Nr. 87 prot

Koplik më: 08 /01/2021

V E N D I M

Nr 84 datë 29 / 12 / 2020

**PËR**

”Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor përkatës, të znj. Leze Vulaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit dhe djegia e plote e banesës, si dhe për akordimin e ndihmës financiare për familjen e këtij shtetases nga buxheti i bashkisë dhe nga buxheti i vitit 2020 në Ministrinë e Mbrojtjes, programi për “emergjencat civile”

**Baza Ligjore**

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar

Ligji për Prefektin e Qarkut

Ligji Nr. 45/2019 Për mbrojtjen civile,

VKM nr.329 datë 16/5/2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”

VKM, Nr.965, datë 02/12/2015 „Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave“.

**Vendosji;**

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për mbështetje financiare të familjes së shtetases Znj. Leze Vulaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit.

2. Të miratojë dokumentacionin tekniko - ligjor përkatës të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe për djegien e shtëpisë.

3. T’i akordojë familjes së shtetases Znj. Leze Vulaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit, dhënien e ndihmës së menjëherëshme/emergjente financiare në vleren/shumen 100.000 (njëqind mijë) lekë ,nga fondi i emergjencave civile te Bashkise Malesi e Madhe në mbështetje te VKB nr 6 date 18.01.2020 për miratimin e buxhetit te vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesem 2020-2022 si dhe sipas shkrese së MFE me nr 23198 prot datë 24.12.2019, familjes së shtetasit znj. Leze Vulaj, të dëmtuar nga fatkeqësi natyrore,

4. T’i paraqesë dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës të familjes së shtetases Znj. Leze Vulaj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit dhe t’i propozojë/kërkojë mbështetje Agjencise Kombetare të Mbrojtjes Civile (AKMC) , në Ministrinë e Mbrojtjes për akordimin e pjesës

së mbetur të ndihmës financiare, për shkak të pamundësisë së Bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën financiare, për shkak të mungesës së fondeve nga ana e Bashkisë.

5. Ndihma financiare për familjen e shtetases Znj.Leze Vulaj, përcaktohet sipas kritereve të VKM-së nr.329,datë 16.05.2012.

6. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetases Znj.Leze Vulaj, objekti shtepi banimi e të cilit është dëmtuar nga rënie e zjarrit.

7. Vlera e dëmeve në orendi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake është 285,336 (dyqind e tetëdhjete e pese mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë) leke. Dëmtime nga ana ndërtimore në vlerën 3,079,146 (tre milion e shtatëdhjetë e nente mijë e njeqind e dyzet e gjashtë ) leke.

Vlera në total e dëmeve është : 3,364,482 (tre milion e treqind e gjashtëdhjetë e kater mijë e katerqind e tetëdhjetë e dy) leke.

8.Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

**KRYETAR**

Ilir Halaj

**SEKRETAR**

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 29.12.2020

Vota Pro 19

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 05.01.2021

